


Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore

Viti 2022

Tiranë, më 03 Korrik 2023: Në vitin 2022, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore arriti në 125,1 nga 112,6 që ishte në 2021, duke shënuar një rritje me 11,1 %. Gjatë këtij viti, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 2,9 %, gjithashtu rritje ka shënuar edhe indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale me 22,1 %, krahasuar me një vit më parë.

Fig. 1 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)



Burimi: Anketa mujore për Produktet Bujqësore, INSTAT

Për publikim 03/07/2023

Tab. 1 Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)

Kodi IÇB	Prodhimet	Pesha në %	2015		2021		2022	
			Viti bazë	Indeksi	Ndryshimi vjetor në %	Indeksi	Ndryshimi vjetor në %	
	Prodhime Bujqësore Gjithsej	100	100	112,6	7,4	125,1	11,1	
I	Prodhimet bimore	56,0	100	114,8	10,8	118,1	2,9	
1	Drithëra	4,2	100	96,7	12,5	132,7	37,3	
2	Bimë Industriale	0,4	100	140,0	4,0	163,4	16,7	
3	Bimë foragjere	3,8	100	99,1	20,7	117,0	18,0	
4	Perime	23,2	100	117,2	9,8	116,3	-0,7	
5	Patate	3,1	100	126,5	28,0	147,2	16,3	
6	Prodhimet e drufrutorëve	17,2	100	115,0	10,8	110,1	-4,2	
6.1	Fruta	8,2	100	132,7	15,3	128,3	-3,3	
6.2	Agrume	1,0	100	89,5	-7,5	88,6	-1,1	
6.3	Rrush	5,5	100	102,2	4,7	100,0	-2,2	
6.4	Ullinj	2,5	100	95,0	14,5	81,3	-14,4	
7	Verë	2,6	100	131,9	-1,1	132,6	0,5	
8	Vaj Ulliri	1,5	100	104,9	-0,3	98,7	-5,9	
II	Prodhimet e blegtorisë	44,0	100	109,7	3,1	134,0	22,1	
9	Mish peshë e gjallë	18,6	100	110,3	3,0	127,9	15,9	
9.1	Gjedhi	8,3	100	105,2	1,8	121,1	15,1	
9.2	Derra	3,1	100	116,9	2,3	131,1	12,2	
9.3	Të imta	5,1	100	115,7	5,0	140,8	21,7	
9.4	Shpendë	2,1	100	108,2	4,0	119,3	10,2	
10	Qumësht	19,7	100	111,3	3,3	143,5	28,9	
10.1	Qumësht lope	14,8	100	111,7	4,5	145,3	30,1	
10.2	Qumësht të tjerë	4,9	100	110,2	-0,4	138,2	25,4	
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	100	102,3	2,7	120,7	18,0	
11.1	Vezë	2,8	100	104,5	2,6	131,5	25,8	
11.1	Mjaltë	2,9	100	100,2	2,8	110,8	10,6	

Burimi: Anketa mujore për Produktet Bujqësore. INSTAT

Tab. 2 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore. 2022 (2015=100)

Kodi IÇB	Prodhimet	Peshane %	Tremujori I 2022		Tremujori II 2022		Tremujori III 2022		Tremujori IV 2022	
			Indeksi	Ndryshimi vjetor %	Indeksi	Ndryshimi vjetor %	Indeksi	Ndryshimi vjetor %	Indeksi	Ndryshimi vjetor %
	Prodhime Bujqësore Gjithsej	100	123,9	10,0	129,7	11,6	119,7	10,9	127,1	11,7
I	Prodhimet bimore	56	129,9	9,5	131,3	6,7	106,7	-0,2	110,3	-2,4
1	Drithëra	4,2	124,7	44,7	143,1	51,0	135,8	38,5	128,2	18,1
2	Bimë Industriale	0,4	156,6	10,6	161,6	21,2	163,0	17,3	171,5	18,7
3	Bimë foragjere	3,8	121,2	30,6	130,5	35,4	112,7	17,2	110,2	1,8
4	Perime	23,2	131,2	1,8	124,2	1,7	98,9	-3,8	112,3	-4,3
5	Patate	3,1	161,3	35,1	155,3	30,3	134,0	17,3	134,2	-13,6
6	Prodhimet e drufrutorëve	17,2	126,6	0,1	139,3	1,2	99,6	-9,8	100,0	-3,3
6.1	Fruta	8,2	142,6	-0,6	142,0	0,5	109,0	-12,8	122,2	0,3
6.2	Agrume	1	88,5	11,8	-	-	-	-	88,6	-6,8
6.3	Rrush	5,5	-	-	-	-	93,6	-8,2	115,2	11,8
6.4	Ullinj	2,5	117,5	-7,1	111,8	11,6	104,1	1,2	67,3	-23,8
7	Verë	2,6	125,0	-5,1	133,8	-2,6	136,6	6,7	130,3	-1,6
8	Vaj Ulliri	1,5	100,1	-4,7	99,7	-5,0	101,1	-3,5	95,7	-8,8
II	Prodhimet e blegtorisë	44	118,1	10,6	127,8	18,6	139,2	27,0	149,4	30,2
9	Mish peshë e gjallë	18,6	116,3	7,9	125,3	16,4	128,8	17,7	139,4	20,3
9.1	Gjedhi	8,3	109,9	4,9	118,2	14,1	124,0	18,4	132,1	22,6
9.2	Derra	3,1	121,4	3,6	131,1	12,1	132,1	13,3	139,6	19,7
9.3	Të imta	5,1	128,4	16,4	137,0	25,4	140,4	23,5	151,0	20,3
9.4	Shpendë	2,1	113,5	11,5	115,5	9,3	115,0	7,1	133,0	12,8
10	Qumësht	19,7	123,2	14,0	132,0	19,9	151,5	35,4	167,6	45,5
10.1	Qumësht lope	14,8	122,8	13,2	131,4	19,1	155,1	37,9	172,1	49,2
10.2	Qumësht të tjerë	4,9	124,9	17,0	133,3	21,8	141,2	28,3	152,2	33,0
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	110,4	9,9	118,0	20,5	123,3	21,6	131,1	19,8
11.1	Vezë	2,8	116,3	12,2	127,9	32,0	135,1	33,3	146,6	26,1
11.1	Mjaltë	2,9	105,0	7,9	108,9	10,2	112,6	10,9	116,6	13,2

(-) Produkte sezonal

Burimi: Anketa mujore për Produktet Bujqësore. INSTAT

Metodologjia

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standartet dhe rregullat e përshkuara në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mblidhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e të dhënave kryhet pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjeve të shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përfshirë taksat. Ato janë llogaritur në Lek. kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë sipas produktit.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për mishin peshë e gjallë dhe prodhimet blegtorale. Çmimet e mishit peshë e gjallë grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjalhtë.

Skema e peshave në Indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore

Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret një skemë e mirëpërcaktuar peshash. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të agreguar indekset në nivel grupi duke prodhuar indeksin vjetor. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore janë konform parimeve të Llogarive Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Skema e peshave për Indeksin e Çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite. Gjatë kësaj periudhe peshat totale dhe peshat tremujore të çmimeve të produkteve bujqësore nuk ndryshojnë.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Indeksi elementar llogaritet sipas formule në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$$

R_i^t : Indeksi elementar për muajin "t" dhe prodhimin "i"

P : Çmimet e grumbulluara

i : Prodhimi "i"

j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1.2.....n)

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Indeksi të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^o}{\sum w_i^o} \right) \cdot 100$$

I : Indeksi i agreguar për periudhën "t"

w_i^o : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin "i"

i : Prodhimi "i"

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë